



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:173887
Datë: 04.04.2022
Numri i dokumentit: 03115547

C.nr.1008/21

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Venhar Salihu, me bashkëpunëtorin profesional Dibran Jusufi, duke vendosur në çeshtjen juridike kontestimore me objekt kontesti anulimi i konkursit, sipas padisë së paditëses Sh. Q. nga Gjilani, të cilën me autorizim e përfaqëson Shefqet Hasimi, avokat nga Prishtina, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria e Arsimit në Gjilan, të cilën me autorizim e përfaqëson Bardhosh Dalipi avokat nga Gjilani, si dhe të ndërhyrësit të thjeshtë Xhelal Jetishi nga Gjilani, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor e publik të datës 09.03.2022 dhe pas pranimit të shpjegimeve përfundimtare, jashtë seancës me datë 25.03.2022, mori këtë:

AKTGJYKIM

- I. **REFUZOHET** në terësi si e pabazuar kërkespadija e paditëses Sh. Q. nga Gjilani, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, me të cilën ka kërkuar që të anulohet konkuri i shpallur me dt. 24.03.2021 dhe të obligohet e paditura që sërish të shpallë konkursin për pozitën e Drejtorit të SH.M.L. Agrobiznesi-Arbëria në Gjilan dhe me anulimin e konkursit të anulohet edhe përzgjedhja e kandidatit Xh. J. I cili është pranuar pa i plotësuar kriteret e konkursit.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Arsy etimi

Paditësja, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të anulohet konkursin për pozitën e drejtorit të SH.M.L. Agrobiznesi në Gjilan dhe çështjen ta rikthejë në rishqyrtim ose të anulohet konkursi i dt. 24.03.2021, pasi që e paditura me datë 26.04.2021 kishte shpallur konkursin për pozitën e drejtorit në SH.M.L. Agrobiznesit dhe Teknologjisë në Gjilan, por që në këtë konkurs kandidati i cili ishte zgjedhur në këtë pozitë nuk kishte plotësuar kushtet e konkursit, andaj paditësja ishte drejtuar komisionit për ankesa dhe parashtresa i cili komision e kishte refuzuar ankesën si të pabazuarndërsa paditësja përmes përfaqësesit të saj me dt. 28.11.2021 e ka precizuar kërkesëpadinë, duke kërkuar nga gjykata që të detyrojë të paditurën që të anulohet konkursin në fjalë dhe të shpallë sërish konkursin për pozitën e drejtorit në SH.M.L. Agrobiznesi në Gjilan.

Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjegjien në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses duke i konsideruar si të pabazuara, pasi që Komisioni për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në procesverbalin e të intervistuarve ka bërë vlerësimin e drejtë në bazë të dokumentacionit relevant dhe njëherit ka respektuar dispozitat ligjore.

Me dt. 15.12.2021, ndërhyrësi i thjeshtë Xh. J. pranë kësaj gjykate ka parashtuar kërkesë për ndërhyrje të thjeshtë në anën e të paditurit për shkak të interesit juridik në këtë çështje juridike kontestimore, duke theksuar se komisioni kishte bërë përzgjedhjen e kandidatëve më të sukseshëm me pikë të mbledhura dhe diku i rekomanduar Kryetarit të Komunës i cili më pasë kishte bërë përzgjedhjen e kandidatit më të mirë me çrat ai ishte rizgjedhur edhe për një mandat për drejtor pasi që paraprakisht kishte qenë drejtor i atij institucioni, ashtu që në këtë konkurs nuk ishte bërë asnjë shkelje ligjore e as procedurale në drejtim të emrimit të drejtorit.

Pretendimet e palëve gjyqësore

Paditësja, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, gjatë seancës përgaditore, seancave kryesore dhe gjatë fjalës përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, përkatësisht precizimit të padisë, duke deklaruar se pas shtjellimit të provave dhe analizimit të të njëjtave, janë vërtetuar në mënyrë bindëse se pretendimet e palës paditëse, ashtu që e njëjta posedon kualifikimin e duhur për pozitën e drejtorit, ndërsa nga konkursi i shpallur u vërtetua se ishin paraparë kriteret për përzgjedhjen e pozitave të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve ashtu siç përcakton edhe Udhëzimi administrativ i nxjerrë nga MASHT-i me numër rendor 151/2020 neni 5 paragrafi 1.6, por që kandidati i zgjedhur – ndërhyrësi i thjeshtë Xh. J. rezulton se është me përgaditje si ekonomist dhe se nuk posedon master e që në bazë të konkursit kandidatit i nevojitej edhe masteri e po ashtu SH.M.L. Agrobiznesi në Gjilan sipas Ministrisë së Arsimit të Kosovës funksionon me kodin numër 10, kod ky që përcakton se është shkollë e profileve bujqësore në kuadër të së cilës është edhe profili i agrobiznesit, andaj vendimi numër 66309 i datës 25.06.2021 është marrë në shkelje të dispozitave ligjore në fuqi por edhe atyre procedurale, ngase Komisioni Vlerësues ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 151/2020, ku si kandidat të sukseshëm ka përzgjedhur ndërhyrësin e thjeshtë Xh. J. me përgaditje të profilit tjetër, duke shtuar faktin se Komisioni Vlerësues nuk kishte kompetencë që të nxirrte vendime por vetëm të bënte rekomadime. Tutje ka shtuar se në dokumentacionin e pranuar përmes postës paditësja nuk figuron askund përveq formularëve të poentimit, formularë këta të cilët nuk përputhen me formularët të cilët i posedon paditësja, andaj mbi bazën e të lartcekurave ka kërkuar nga gjykata që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrohet e paditura që brenda afatit ligjor të shpallë konkursin për drejtor në SH.M.L. Agrobiznesi – Arbëria në Gjilan, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, gjatë seancës përgaditore, kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë përgjegjës në padi dhe të thënave në seance në lidhje me këtë çështje, duke kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, ngase nga provat e administruara me asnjë provë nuk është vërtetuar bazueshmëria e kërkesëpadisë, ashtu që procedurat përzgjedhëse sipas konkursit të publikuar për shpalljen e vendit të punës mbi përzgjedhjen e kandidatëve nme numër.66309 të datës 25.06.2021 kanë qenë në rregull dhe janë zhvilluar konform rregullave ligjore për

konkursin e vendeve të punës për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë në Arsim në Kkomunën e Gjilanit, ku kandidati i zgjedhur Xh. J. kishte arritur 88.8 pikë në total, ndërsa paditësja kishte arritur 70.30 pikë. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave me datë 09.07.2021 kishte pranuar ankesën e paditëses për vendin e punës për drejtor në SH.M.L. Agrobiznesit dhe Teknologjisë “Arbëria” në Gjilan, ku gjatë administrimit të provave materiale në tërësi komisioni i ankesave nuk kishte gjetur ndonjë parregullësi në prcesvebalet e të intervistuarve, andaj mund të konkludohet se përzgjedhja e emërimi i drejtorit është bërë duke i respektuar dispozitat ligjore.

Provat e administruara

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e provave material dhe personale si: Tre formularët C-Protokolli të intervistimit për kandidaten – paditësen Sh. Q., Formulari D ku shihen pikët e kandidatëve në konkurin e kontestuar, Dosja për kandidatët Sh. Q., Xh. J., F. L. dhe N. H., Vendimi nr.66309, i dt. 25.06.2021, Konkursi i shpallur nga e paditura, përgjegjia në ankesë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave i dt.09.07.2021, Vendimi i dt.02.07.2021 i lëshuar nga Inspektoriati i Punës, Diplomat e lëshuara nga U.P. “Hasan Prishtina” për studime të rregullta dhe master në emër të paditëses si dhe dëgjimin e dëshmitarit Nexhat Hajrullahu.

Gjendja faktike e vërtetuar

Duke vlerësuar secilën provë veç e veç dhe gjitha së bashku siç ka paraparë neni 8 i LPK-së, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktikë:

Në këtë çështje juridike kontestimore nuk ishte kontestues fakti se e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtorja e Arsimit me dt.26.04.2021, kishte shpallur konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës në mes tjerash edhe për drejtor të SH.M.L. – Agro Biznesi “Arbëria” në Gjilan. Po ashtu nuk ishte kontestues fakti se në këtë konkurs kishte aplikuar dhe kishte plotësuar kushtet edhe paditësja Sh. Q..

Kontestuese ishte fakti nëse komisioni vlerësues kishte zbatuar dispozitat ligjore me rastin e vlerësimit dhe poentimit të kandidatëve të cilët kishin marrë pjesë në këtë konkurs.

Nga Formulari C-Protokolli i Intervistimit, të përpiluar nga vlerësuesi N. H., gjykata vëretoi faktin se paditësja Sh. Q., nga kjo anëtare e komisionit ishte vlerësuar me gjithësej 55 pikë.

Nga Formulari C-Protokolli i Intervistimit, të përpiluar nga vlerësuesja D. K., gjykata vëretoi faktin se paditësja Sh. Q., nga ky anëtar i komisionit ishte vlerësuar me gjithësej 74 pikë.

Nga Formulari C-Protokolli i Intervistimit, të përpiluar nga vlerësuesi A. K., gjykata vëretoi faktin se paditësja Sh. Q., nga ky anëtar i komisionit ishte vlerësuar me gjithësej 62 pikë.

Nga Formulari D-Rangimi i kandidatëve të vlerësuar nga komisioni përzgjedhës për drejtor në SH.M.L. “Arbëria” në Gjilan, gjykata vëretetoi faktin se N. H. kishte arritur 62 pikë, kandidati Xh. J. kishte arritur 88.8 pikë dhe kandidati Fadil Latifi kishte aritur 68 pikë.

Nga Vendimi nr.66309, i dt. 25.06.2021, lëshuar nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Gjilanit, gjykata vërtetoi faktin se ndërhyrësi i thjeshtë Xh. J. ishte përzgjedhur drejtor në Sh.M.L. Agro Biznesi “Arbëria”.

Nga Përgjegjia në Ankesë e datës 28.06.2021 ndaj ankesës së paditëses Sh. Q., të lëshuar nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave të Drejtrisë Komunale të Komunës së Gjilanit, gjykata vërtetoi faktin se ky komision kishte konstatuar se nuk kishte pasur parregullësi gjatë procedurave të rekrutimit për pozitën e drejtorit në Sh.M.L. Agro Biznesi “Arbëria”.

Nga Vendimi i lëshuar nga Inepsktoriati i Punës të dt. 26.07.2021, gjykata gjeti se ky organ kishte konstatuar jokompetencën për shqyrtimin në procedurën administrative sipas ankesës së parashtruar nga paditësja Sh. Q. lidhur me kontestin nga marrëdhënia e punës.

Nga degjimi i dëshmitarit S. F. gjykata ka vërtetuar faktin se paditëses vendimi i Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave i është dorzuar me dt.15.11.2011, kurse paditësja padin në këtë gjykatë e ka dorzuar me dt.12.12.2011, që do të thotë se padinë e ka ushtruar mbrenda afatit 30 ditorë. Dëshmitari N. H. në deklaratën e tijë në shqyrtim kryesor, ka deklaruar: se në konkursin e kontestuar ai kishte qenë kryetar i komisionit dhe se në atë konkurs kishin marrë pjesë paditësja dhe ndërhyrësi i thjeshtë, ashtu që fillimisht në këto lloj të konkurseve fillimisht hapen dokumentacionet e kandidatëve dhe vlerësohen se cilët kandidat i plotësojnë kushtet, ku më pas fillohet me procedurat e konkursit ashtu që fillimisht intervistohen kandidatët me pyetje që kanë të bëjnë rreth planit zhvillimor të shkollës, e më pas poentimi bëhet në mënyrë diskrecionale nga antarët e komisionit dhe në fund mbledhen pikët e kështu përfundimisht bëhet rekomandimi tek Kryetari i Komunës, ndërsa në këtë konkurs ishin propozuar tre kandidat, por që në mesin e tyre nuk kishte qenë paditësja Sh. Q., e po ashtu kandidati i përzgjedhur-ndërhyrësi i thjeshtë Xh. J. kishte plotësuar kushtin e profilit të kualifikimit pasi që shkolla e mesme e Agrobiznesit kishte më shumë orë të ekonomisë sesa të bujqësisë dhe se për atë konkurs ishte kërkuar vetëm që kandidati të kishte të përfunduar fakultetin katër vjeçar, ndonëse edhe ndërhyrësi i thjeshtë kishte të përfunduar edhe masterin.

Prandaj, nga provat e lartëcekura gjykata ka gjetur se paditësja nuk ka arritur që me prova të argumentoj shkeljet në konkursin e kontestuar, ashtu që paditësja ka aplikuar në një konkurs publik ku Komisioni Intervistues e ka intervistuar të njëjtën dhe e ka vlersësuar sipas pikëve të lartcekura, pikë këto të cilat kishin qenë të pamjaftueshme që e njëjta të rekomandohej nga komisioni për përzgjedhje tek kryetari i komunës, ndërsa pas ankesës të paraqitur nga paditësja, Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave kishte konstatuar se nuk kishte pasur parregullësi gjatë procedurave të rekrutimit për pozitën e drejtorit në Sh.M.L. Agro Biznesi “Arbëria. Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet e paditëses se personi i cili ishte zgjedhur në pozitën e drejtorit në SH.M.L. Agro Biznesi “Arbëria”, përkatësisht se ndërhyrësi i thjeshtë XH. J. nuk i plotësonte kriteret e kërkuara për tu zgjedhur, ngase i njëjti kishte plotësuar kushtet ligjore për përzgjedhje, e po ashtu nuk qëndron as pretendimi se i njëjti me profesion është ekonomist dhe se kjo lëndë nuk konsiderohet lëndë profesionale, ngase Shkolla e Agro Biznesit “Arbëria” në Gjilan në kuadër të fushveprimit arsimor ndër të tjera posedon fushën e Agrobiznesit që lëndë të profilit ka edhe ekonominë.

Gjykata ka administruar edhe prova të tjera materiale, por të njejtat nuk i arsyetoi pasi që nuk do të kishin ndikim që të vendosej ndryshe në këtë qështje siç është vendosur.

Vendimi i gjykatës

Gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të spjeguar si më lartë, dhe bazuar në nenin 126 dhe 136 të ligjit 02/L-28 për Procedurën Administrative, ka ardh në përfundim se paditësja nuk ka bazë ligjore, pasi që në bazë të dispozitave të lartëcekura Komisioni Komunal ka pasur vepruar konform Udhëzimit Administrativ nr.151-2020 për procedurat dhe kriteret për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo arsimore dhe afëtesuese, prandaj edhe nisur nga kjo u vendos si në pikën I të dispozitivit

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit që secila nga palët ti bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore, duke u bazuar në nenin 450, 463.3 dhe 465.3 të LPK-ës, pasi që paditësja nuk pati sukses në këtë çështje kontestimore, kurse në anën tjetër e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga arsyet e cekura më lart e bazuar në nenin 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C. nr. 1008/21, dt. 25.03.2022

Gjyqtari,
Venhar Salihu

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet në ekzemplarë të mjaftueshëm përmes kësaj gjykatë.